UDHËZIM
Nr. 90, datë 27.6.2023

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË U OFROHEN SUBJEKTEVE PUBLIKE NGA SHOQËRIA"ILLYRIAN GUARD" SHA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, si dhe të pikës 7, të vendimit nr. 177, datë 4.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e shoqërisë 'Illyrian Guard' sh.a., dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie", ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

1. Institucionet shtetërore dhe shoqëritë aksionare me kapital shtetëror të buxhetojnë tarifat e shërbimeve në fushën e sigurisë, si më poshtë:

TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SHOQËRISË "ILLYRIAN GUARD" SHA PËR SUBJEKTET PUBLIKE		
SHËRBIM SIGURIE 1.3.A		
I	SHËRBIM RUAJTJEJE ME PUNONJËS SHËRBIMI SIGURIE	
	Mënyra e shërbimit	*Tarifë/punonjës në muaj (lek pa TVSH)*
1	Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (tre turne)	87,892
2	Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (turn i parë)	76,014
3	Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (turn i parë dhe i dytë)	78,337
4	Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (turn i dytë)	80,662
5	Shërbim ruajtje me punonjës shërbimi (turn i tretë)	106,999
II	SHËRBIM REAGIMI ME GRUP VERIFIKIMI SINJALESH	
	Shërbim	*Tarifë/muaj (lek pa TVSH)*
	Shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh	11,322
III	SHËRBIM RUAJTJEJE ME SISTEME ELEKTRONIKE	
	Shërbim	*Tarifë/shërbim në muaj (lek pa TVSH)*
1	Shërbim sigurie me kamera teke dhe alarm	37,561
2	Shërbim sigurie me NVR deri në 4 kanale dhe alarm	88,701
3	Shërbim sigurie me NVR 8-16 kanale dhe alarm	148,400
4	Shërbim sigurie me tra parkimi	19,650
5	Shërbim sigurie me akses kontroll me bravë elektrike	3,626
6	Shërbim sigurie me akses kontroll *face dedection* me bravë elektrike	4,993
7	Shërbim sigurie me vëzhgim, alarm, tra dhe akses kontrolli	159,870
8	Shërbim sigurie me alarm	11,756
	SHËRBIM SIGURIE 1.3.B	
IV	SHËRBIM SIGURIMI DHE SHOQËRIMI I VLERAVE MONETARE E SENDEVE TË ÇMUARA	
	Shërbim	*Tarifë/ditë për lëvizje (lek pa TVSH)*
1	Kategoria A - lëvizje urbane	3,368
2	Kategoria A - lëvizje interurbane	4,398

3	Kategoria B - lëvizje urbane	4,128
4	Kategoria B - lëvizje interurbane	5,158
5	Kategoria C - lëvizje urbane	8,192
6	Kategoria C - lëvizje interurbane	11,282
7	Kategoria D - lëvizje urbane	8,786
8	kategoria D - lëvizje interurbane	11,876
9	Kategoria E - lëvizje urbane	9,709
10	kategoria E - lëvizje interurbane	12,799
11	Kategoria F - lëvizje urbane	10,303
12	Kategoria F - lëvizje interurbane	13,393

2. Institucionet shtetërore dhe shoqëritë aksionare me kapital shtetëror, në rast nevoje, të buxhetojnë tarifat e shërbimeve për transport personalitetesh me automjete të "Illyrian Guard", si më poshtë:

TRANSPORT ME SUV 2. NAFTË	
Kostoja	**Kostoja/ditë përdorimi (lek)**
Qira dite/makine	4,000
Kosto shoferi/ditë	2,917
Kosto karburanti bazuar ne çmim burse (13 litra/100 km) çmim 144.39 lekë/litër	1,877
Nëntotal	**8794**
Shpenzime administrative për përgjegjësin + punonjësin e shoqërimit fizik	1,975
Shpenzime administrative për shefin e VIP	1,284
	12,053
Kosto administrative 3%	361
Fitimi 20%	2,482
Tarifë ditore	**14,896**

TRANSPORT ME ACCENT 1.4 BENZINË	
Kostoja	**Kostoja/ditë përdorimi (lek)**
Qira dite/makine	3,000
Kosto shoferi/ditë	2,917
Kosto karburanti bazuar në çmim burse (11 litra/100 km) çmimi 136.7 lekë/litër	1,504
Nëntotal	**7,421**
Shpenzime administrative për përgjegjësin +punonjësin e shoqërimit fizik	1975
Shpenzime administrative për shefin e VIP	1,284
	10,680
Kosto administrative 3%	320
Fitimi 20%	2,228
Tarifë ditore	**13,228**

TRANSPORT ME ACCENT 1.6 NAFTË	
Kostoja	**Kostoja/ditë përdorimi (lek)**
Qira dite/makine	3200

Kosto shoferi/dite	2917
Kosto karburanti bazuar në çmim burse (9 litra/100 km)144.39 lekë/litër	1300
Nëntotal	**7417**
Shpenzime administrative për përgjegjësin + punonjësin e shoqërimit fizik	1975
Shpenzime administrative për Shefin e VIP	1,284
	10676
Kosto administrative 3%	320
Fitimi 20%	2199
Tarifë ditore	**13,195**

TRANSPORT ME HYUNDAI I20 1.2 BENZINË	
Kostoja	**Kostoja/ditë përdorimi (lek)**
Qira dite/makine	2800
Kosto shoferi/dite	2917
Kosto karburanti bazuar në çmim burse (8 litra/100 km) çmimi 136.7 lekë/litër	1094
Nëntotal	**6811**
Shpenzime administrative për përgjegjësin + punonjësin e shoqërimit fizik	1975
Shpenzime administrative për shefin e VIP-së	1284
	10070
Kosto administrative 3%	302
Fitimi 20%	2074
Tarifë ditore	**12446**

3. Institucionet për përzgjedhjen e shërbimit që do të kërkojnë nga shoqëria "Illyrian Guard" sh.a., të bazohen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Shoqëria "Illyrian Guard" sh.a. për zbatimin e këtij udhëzimi.

5. Udhëzimi i përbashkët nr. 407/1, datë 14.6.2019, i ministrit të Financave dhe i ministrit të Brendshëm, "Për mënyrën e përllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, nga shoqëria 'Illyrian Guard' sh.a.", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

ANEKS NR.1
SHËRBIME TË SHOQËRISË "ILLYRIAN GUARD" SHA

1. Sigurimi fizik me punonjës shërbimi sigurie

Ky shërbim ofrohet sipas nënkategorive të mëposhtme, bazuar në kërkesat dhe aktivitetin e subjekteve të cilët paraqesin nevojën për shërbimin e sigurimit fizik me punonjës shërbimi sigurie, si më poshtë:

Mënyra e shërbimit		Koeficienti
E hënë–e premte	Një turn (8 ore)	**1,18**
	1.5 turne (12 ore)	**1,77**
	Dy turne (16 ore)	**2,36**
	Tre turne (24 ore)	**3,54**
E hënë–e premte	Një turn (8 ore)	**1,42**
	1.5 turne (12 ore)	**2,13**
	Dy turne (16 ore)	**2,84**
	Tre turne (24 ore)	**4,26**
E hënë–e premte	Një turn (8 ore)	**1,66**
	1.5 turne (12 ore)	**2,49**
	Dy turne (16 ore)	**3,32**
	Tre turne (24 ore)	**4,98**

2. Shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh

Ky shërbim ofrohet për institucione të cilat kanë investuar në vendosje të sistemeve të vëzhgimit dhe të alarmit me fonde të tyre.

Shërbimi nga shoqëria "Illyrian Guard" sh.a. konsiston në:

- Monitorim 24/7 nga Qendra e Kontrollit;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike.

3. Sigurimi ruajtje fizike me sisteme elektronike

3.1 Shërbimi i ruajtjes fizike me kamera teke dhe alarm

Shërbimi nga shoqëria "Illyrian Guard" sh.a. konsiston në:

- Vendosje paneli alarmi në objekt;
- Vendosje e 1 kamerë të jashtme;
- Monitorim 24/7 i alarmit dhe kamerës;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike.

3.2 Shërbimi i ruajtjes fizike me vëzhgim (NVR 0-4 kanale) dhe alarm

Shërbimi konsiston në:

- Vendosje paneli alarmi në objekt;
- Vendosje e një sistemi vëzhgimi të përbërë nga NVR 0–4 kanale dhe kamera të brendshme/jashtme (1–4 kamera)
- Monitorim 24/7 i alarmit dhe kamerave;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike.

3.3 Shërbimi i ruajtjes fizike me vëzhgim (NVR 8-16 kanale) dhe alarm

Shërbimi konsiston në:

- Vendosje paneli alarmi në objekt;
- Vendosje e një sistemi vëzhgimi të përbërë nga NVR 8–16 kanale dhe kamera të brendshme/jashtme (8–16 kamera);
- Monitorim 24/7 i alarmit dhe kamerave;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;
- Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluara.

3.4 Shërbimi i ruajtjes fizike me barrierë elektronike

Shërbimi konsiston në:

- Vendosje akses kontrolli dhe barriere elektronike (tra parkimi, tripod, pistona ose tip tjetër barriere elektronike);
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;
- Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluara;
- Karta aksesi.

3.5 Shërbimi i ruajtjes fizike me akses kontrolli me bravë elektrike

Shërbimi konsiston në:

- Vendosje akses kontrolli;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;
- Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluara;
- Karta aksesi.

3.6 Shërbimi i ruajtjes fizike me akses kontrolli *face dedection* me bravë elektrike

Shërbimi konsiston në:
- Vendosje akses kontrolli me opsion të njohjes së fytyrës;
- Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;
- Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluara;
- Karta aksesi.

3.7 Shërbimi i ruajtjes fizike me vëzhgim, alarm, tra dhe akses kontrolli

Shërbimi konsiston në:

a) Vendosje e një sistemi vëzhgimi të përbërë nga NVR 5–16 kanale dhe kamera të brendshme/jashtme (5–16 kamera);

b) Vendosje akses kontrolli;

c) Vendosje e një sistemi alarmi;

d) Vendosje barriere elektronike (tra parkimi, tripod, pistona ose tip tjetër barriere elektronike);

e) Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;

f) Monitorim në kohë reale 24/7 përmes Qendrës së Kontrollit;

g) Mirëmbajtje të pajisjeve të instaluara;

h) Karta aksesi.

3.8 Shërbimi i ruajtjes fizike me vëzhgim, alarm, tra dhe akses kontrolli

Shërbimi konsiston në:

a) Vendosje e një sistemi alarmi;

b) Reagim me punonjës verifikimi sinjalesh elektronike;

c) Monitorim në kohë reale 24/7 përmes Qendrës së Kontrollit;

d) Mirëmbajtje e pajisjeve të instaluara.

4. Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e të sendeve të çmuara gjatë transportit

4.1 Kategoria A: **Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë deri në 10.000.000 lekë**

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë);

b) Jo më pak se dy punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve i certifikuar për drejtues mjeti);

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së;

d) Sistem gjurmimi GPS;

e) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

f) Kamera për lexim automatik të targave.

4.2 Kategoria B: **Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 10.000.000 lekë deri në 25.000.000 lekë**

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave monetare nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-3 (me frëngji për hapje zjarri me armë);

b) Jo më pak se tre punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve i certifikuar për drejtues mjeti);

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së;

d) Sistem gjurmimi GPS;

e) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

f) Kamera për lexim automatik të targave.

4.3 Kategoria C: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 25.000.000 lekë deri në 75.000.000 lekë:

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave monetare nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-4;

b) Jo më pak se katër punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (njëri prej të cilëve i certifikuar për drejtues mjeti);

c) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së;

d) Sistem gjurmimi GPS;

e) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

f) Kamera për lexim automatik të targave;

g) Dy automjete të blinduara, përkatësisht njëri para dhe tjetri pas automjetit të blinduar ku janë vendosur vlerat monetare.

4.4 Kategoria D: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 75.000.000 lekë deri në 150.000.000 lekë

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave monetare nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-5;

b) Dy automjete të blinduara BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë) për transportimin e punonjësve të SHPSF-së;

c) Jo më pak se pesë punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4, (dy prej të cilëve të certifikuar për drejtues mjeti);

d) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së dhe ndërmjet mjeteve të eskortës;

e) Sistem gjurmimi GPS;

f) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

g) Kamera për lexim automatik të targave

4.5 Kategoria E: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 150.000.000 lekë deri 550.000.000 lekë

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet të blinduar me pjesë të ndarë të vendit të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-6;

b) Dy automjete të blinduara BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë), për transportimin e punonjësve të SHPSF-së;

c) Jo më pak se gjashtë punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B 4 (dy prej të cilëve të certifikuar për drejtues mjeti);

d) Sistem të bllokimit motorik të automjetit që transporton vlera monetare;

e) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së dhe ndërmjet mjeteve të eskortës;

f) Sinjali i njoftimit SOS;

g) Sistem gjurmimi GPS;

h) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

i) Kamera për lexim automatik të targave.

4.6 Kategoria F: Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë nga 550.000.000 lekë – 950.000.000 lekë:

Shërbimi konsiston në:

a) Një automjet me pjesë të ndarë të transportit të vlerave nga kabina e drejtuesit të mjetit i nivelit BR-7;

b) Dy automjete të blinduara BR-4 (me frëngji për hapje zjarri me armë) për transportimin e punonjësve të SHPSF-së;

c) Jo më pak se shtatë punonjës shërbimi të SHPSF-së me armatimin përkatës B1, B4 (tre prej të cilëve të certifikuar për drejtues mjeti);

d) Sistem të bllokimit motorik të automjetit që transporton vlera monetare;

e) Sistem komunikimi të vazhdueshëm me Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së dhe ndërmjet mjeteve të eskortës;

f) Sinjali i njoftimit SOS;

g) Sistem gjurmimi GPS;

h) Monitorimi me kamera CCTV me rezolucion të lartë, të vendosura brenda dhe jashtë mjetit të blinduar;

i) Kamera për lexim automatik të targave

4.7 Sigurimi i vlerave monetare, materialeve dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, me vlerë mbi shumën 950.000.000 lekë

Transportimi i vlerave monetare mbi shumën 950.000.000 lekë, përveç masave të parashikuara në kategorinë F, pikat "a" dhe "b", nga shërbimi privat i sigurisë fizike, strukturat e Policisë së Shtetit në territorin e të cilit do të lëvizë eskorta, planifikojnë dhe marrin masa shtesë sigurie, sipas përcaktimit të bërë nga legjislacioni në fuqi.